



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 23.12.2021

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, pas shtimit të fondit me Aktin Normativ me nr. 34 datë 03.12.2021 si dhe urdhrin të Ministrit të MBZHR Nr. 642, datë 23.12.2021 “Për Rialokimin e Fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Bujqësor për vitin 2021”

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve si dhe numrin e kodit të aplikimit që përfshihet mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matrikulluar – Vija e financimit ishte në numrin rendor 4013 për kodin e aplikimit me numër 6789 - Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 4361, për kodin e aplikimit me numër 7340.

Agropikat janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Fermerët të cilët iu përshihet aplikimi me fond të buxhetit të shtetit në datë **23.12.2021 për masën 1**, kanë afatin e dorëzimit të dokumenteve shtesë deri në datë **28.12.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.